



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR
AGJENCINË SHETETËRORE PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE
PERSONALE PËR VITIN FINANCIAR TË PËRFUNDUAR
MË 31 DHJETOR 2018

Prishtinë, qershor 2019

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Emine Fazliu, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Shefkije Beka Gërvalla (Udhëheqëse e ekipit) dhe Mexhit Ferati (Anëtar i ekipit), nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Shkëlqim Xhema.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	10
4 Qeverisja e mirë.....	14
5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	16
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	18
Shtojca II: Letërkonfirmimi.....	20

Përmbledhje e përgjithshme

Raporti përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2018, i cili përfshinë Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2018 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 14/11/2018.

Auditimi është fokusuar në:



Niveli i angazhimit për të kryer auditimin është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm


Opinion i pamodifikuar

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2018 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Më gjerësisht shih pjesën 2.1 të këtij raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e opinionëve, sipas SNISA-ve.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore



Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2018

Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresoj të gjitha rekomandimet e dhëna.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson bashkëpunimin e menaxhmentit dhe personelit të agjencisë gjatë procesit të auditimit.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase; dhe
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Ne kemi analizuar veprimtarinë e Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (më tutje Agjencia), nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e AP-së.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përmbledhje të detajuar të gjetjeve tona të auditimit dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm

Auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese dhe cilësinë e saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV, përfshirë deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i pamodifikuar

Ne kemi audituar PFV-të e Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, shpalosjet dhe raportet tjera përcjellëse.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV

Drejtori i Përgjithshëm dhe Zyrtari Kryesor Financiar janë përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar, dhe për kontrollet e brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Drejtori i Përgjithshëm në mungesë të Mbikëqyrësit Kryesor Shtetëror të Agjencisë është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Agjencisë.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave të SNISA-ve, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbuloj çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Agjencia kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullat Financiare nr. 01/2013 dhe 02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve; dhe
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK).

Në kontekst të PFV-ve dhe kërkesave tjera për raportim të jashtëm, ne nuk kemi identifikuar ndonjë parregullsi. Marrë parasysh çka u tha më lart, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në Ministrinë e Financave, konsiderohet e saktë dhe e drejtë.

2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Nuk kemi rekomandime lidhur me PFV-të.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, prokurimin, burimet njerëzore, pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Menaxhimi financiar dhe kontrolli efektiv kërkojnë procese të rishikimit dhe udhëzues përcjellës të cilët sigurojnë zbatimin e plotë të ligjeve, rregulloreve të brendshme dhe proceseve të tjera të kontrollit.

Agjencia ka kontrole të mira në raport me obligimet statutorë të saj. Vlen të theksohet se procedurat e prokurimit publik janë zhvilluar nga Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP) siç parashihet me Ligjin e Prokurimit Publik (LPP). Megjithatë, për Agjencinë sfidë mbetet mos vënia në funksion e sistemit e-Pasuria.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
Burimet e Fondeve:	364,067	253,785	220,757	212,288	268,062
Granti i Qeverisë -Buxheti	364,067	253,785	220,757	212,288	268,062

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 110,282€. Ky zvogëlim është rezultat i reduktimit të grantit qeveritar me vendime të Qeverisë², ku prej kategorisë së pagave dhe mëditjeve ishte zvogëluar buxheti për kursime në vlerë 107,030€, si dhe nga kategoria e shërbimeve komunale 3,253€.

Në vitin 2018, ASHMDHP ka shpenzuar 87% të buxhetit final, me një përmirësim prej 12% krahasuar me vitin 2017 që ishte 75%.

¹ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

² Vendimi i Qeverisë për kursime buxhetore Nr. 02/70 i dt. 19.10.2018 dhe vendimit me Nr.07/80 i dt. 18.12.2018

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	364,067	253,785	220,757	212,288	268,062
Pagat dhe Mëditjet	227,169	120,139	120,139	117,811	162,358
Mallrat dhe Shërbimet	130,448	130,448	99,286	94,056	103,343
Shërbimet komunale	6,450	3,197	1,332	421	2,361

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore përfshirë arsyet dhe ndikimin që kanë pasur janë dhënë si në vijim:

- Zvogëlimi i buxhetit final për paga dhe mëditje ishte bërë me vendime të Qeverisë³ për kursime buxhetore për 107,030€. Ky kursim buxhetore ishte për shkak të mos emërimit të pesë anëtarëve të Këshillit nga Kuvendi i Kosovës, e ku vlera vjetore e planifikuar e pagave të tyre ishte 83,883€. Buxheti final për këtë kategori ishte shpenzuar 100%;
- Buxheti final krahasuar me atë fillestar për kategorinë e mallrave dhe shërbimeve nuk kishte ndryshime. Realizimi i buxhetit për këtë kategori ishte 76%, përqindje kjo që ndërlihet me mos përzgjedhjen e anëtarëve të këshillit të Agjencisë nga Kuvendi; dhe
- Buxheti final për komunalitet ishte reduktuar për vlerën 3,253€. Te kjo kategori, shpenzimi i ishte 1,332€ apo 42% buxhetit final, për faktin se shpenzimet ishin bërë vetëm për telefoni fikse pasi që të gjitha shpenzimet komunale të tjera të objektit të Agjencisë i kishte mbuluar Ministria e Administratës Publike (MAP).

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

³ Vendimi Nr. 02/70 i dt. 19.10.2018 dhe vendimi Nr. 07/80 i dt. 18.12.2018

3.1.1 Pagat dhe mëditjet

Pagat dhe mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave që menaxhohet nga MAP dhe MF. Kontrollat që operojnë në nivel të Agjencisë kanë të bëjnë me kontrollin e pagesave çdo muaj, verifikimin e ndryshimeve të mundshme, rishikimin e buxhetit për këtë kategori dhe barazimin me Thesarin.

Buxheti final për kategorinë e pagave dhe mëditjeve ishte 120,139€, i cili ishte shpenzuar në tërësi (100%). Numri i aprovuar i stafit për vitin 2018 ka qenë 24 pozita, ndërsa numri aktual i të punësuarve në fund të vitit ishte 17 punonjës. Prej këtyre pesë (5) pozita janë të anëtarëve të Këshillit të cilët ende nuk janë emëruar nga Kuvendi i Kosovës si dhe dy pozita të tjera.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.1.2 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime (përfshirë komunalit) në vitin 2018 ishte 133,645€, ndërsa ishin shpenzuar 100,618€ apo 75%. Ato kanë të bëjnë kryesisht me shpenzime të trajnimit, shpenzimeve të mirëmbajtjes dhe riparimit, regjistrimit dhe sigurimit të veturave, derivateve dhe shpenzimeve tjera.

Agjencia përpos shpenzimeve të telefonisë nuk ka shpenzime tjera komunale, pasi që shpenzimet komunale mbulohen nga MAP-i.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.2 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Pasuria kapitale mbi 1,000€ e prezantuar në PFV ishte në vlerë 39,487€, pasuritë jo-kapitale nën 1,000€ ishin në vlerën 10,859€ ndërsa vlera e stoqeve ishte zero.

Ne kemi rishikuar nëse procesi i regjistrimit dhe mënyra e mbajtjes së evidencës është në pajtueshmëri me kërkesat e Rregullës Financiare Nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare të Organizatave Buxhetore. Lidhur me testet tonë, ne kemi identifikuar çështjen si në vijim

Çështja B1⁴ - Mos funksionalizimi i sistemit e-pasuria

Gjetja Rregullorja Nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare thekson se pasuritë kapitale duhet të regjistrohen në regjistrin kontabël - SIMFK ndërsa pasuritë jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin e - Pasuria.

Përkundër rekomandimit të vitit të kaluar lidhur me pasuritë, Agjencia ende nuk e ka në funksion sistemin e-pasuria dhe se raportimi i pasurive nën 1,000€ në PFV bëhet nga formati Excel. Lidhur me këtë, Agjencia kishte bërë përpjekje për funksionimin e sistemit e-pasuria duke caktuar një zyrtar, i cili pasi ishte certifikuar kishte dhënë dorëheqje. Pas kësaj agjencia ka caktuar një zyrtar të ri për plotësimin e kësaj pozite, mirëpo ky i fundit ishte në ndjekje të trajnimit dhe certifikimit.

Në mungesë të qasjes dhe certifikimit të zyrtarit të Agjencisë, mbetet ende i pa funksionalizuar sistemi e-pasuria dhe si rezultat pasuritë mbahen dhe raportohen nga formati në Excel. Për pasuritë e testuar në këtë format nuk kemi identifikuar ndonjë dobësi.

Rreziku Mos funksionalizimi i sistemit e-pasuria dhe raportimi i pasurive nën 1,000€ në PFV jo nga regjistri i e-pasurisë është në kundërshtim me rregulloren Nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare si dhe rrit rrezikun e shpalosjes jo të saktë dhe të plotë të pasurive nën 1,000€ në PFV.

Rekomandimi B1 Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj funksionalizimin e sistemit e-pasuria dhe trajnimin e zyrtarit të pasurive nga ana e MAP-it.

⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
 Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
 Çështja C dhe Rekomandimi C - nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura

3.3 Obligimet e papaguara

Pasqyra e obligimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2018 ishte 1,716€. Këto obligime janë bartur për t'u paguar në vitin 2019. Arsyeja e mos pagesës ishte pranimi i faturave pas kalimit të afatit të zotimit.

Raportimi i obligimeve ishte bërë në përputhje me Rregulloren Nr.02/2013 për Raportimin e Obligimeve të Papaguara.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4 Qeverisja e mirë

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmerr veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollat. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK nga ana e organizatave buxhetore monitorohet edhe nga plotësimi i listave kontrolluese të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat i dorëzohen Ministrisë së Financave.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentët tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Agjencia në përgjithësi ka kontrolle të mira në raport me obligimet ligjore të saj. Menaxhimi financiar dhe kontrolli ka dëshmuar proces të mirë të rishikimit dhe siguri në zbatimin e legjislacionit dhe proceseve të tjera të kontrollit.

Agjencia kishte përgatitur regjistrin e rreziqeve, duke identifikuar të gjitha rreziqet domethënëse që mund të kenë ndikim tek organizata në lidhje me arritjen e objektivave të saj.

4.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Auditimi i brendshëm është segment i rëndësishëm për të siguruar menaxhmentin e lartë se mekanizmat e kontrollit të brendshëm janë dizajnuar dhe zbatohen në mënyrën e duhur. Aty ku vërehet se kontrollet e brendshme nuk funksionojnë si duhet, auditimi i brendshëm ofron këshilla dhe rekomandime se si ato të përmirësohen.

Në bazë të UA Nr. 23/2009 për Themelimin dhe Funksionimin e Njesisë së Auditimit të Brendshëm (NJAB), Agjencia nuk i plotëson kriteret për themelimin e kësaj njësie. Lidhur me këtë, në muajin janar dhe nëntor të vitit 2018 kishte kërkuar nga NJAB në kuadër të MF-së për të kryer shërbimet e auditimit të brendshëm.

NJAB e MF kishte kryer një auditimi për funksionimin e Agjencisë, për të cilin ishin marrë në konsideratë rekomandimet e dhëna dhe ishte përgatitur plani për zbatimin e të tyre.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranim i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

Agjencia ka përgatitur regjistrin e rreziqeve krahas planit strategjik, duke identifikuar rreziqet domethënëse që mund të kenë ndikim tek organizata në lidhje me arritjen e objektivave të saj. Po ashtu, është caktuar edhe zyrtari që do të bëjë monitorimin e rreziqeve. Procesi i raportimit të brendshëm në organizatë funksionon sipas strukturës organizative. Lidhur me këtë, menaxhmenti mban takime të rregullta, duke raportuar dhe diskutuar për të gjitha aktivitetet.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e vitit 2017 të Agjencisë ka rezultuar me pesë rekomandime. Për këtë, Agjencia kishte përgatitur planin e veprimit ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatohet rekomandimet e dhëna.

Prej pesë rekomandimeve, tri ishin zbatuar, një ishte përsëritur dhe një është konsideruar i mbyllur. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë trajtuar ato, shih tabelën 3 në vijim:

Tabela 3 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2018

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2017	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	Pagat dhe shtesat	Këshilli Drejtues/Drejtori i Ekzekutiv duhet të siguroj që pozita kyçe e lartcekur të jetë e aprovuar me buxhet dhe sipas kërkesave të LMFPP-së dhe të parandalojë ushtrimin e këtyre funksioneve nga personeli jo adekuat, me qëllim të përmirësimit të aktiviteteve në këto funksione.	Drejtori ka caktuar ZKF-në, si dhe në fillim të vitit 2019 e ka caktuar certifikuesen me konkurs të brendshëm, ndërsa zyrtarja e prokurimit është me detyrë shtesë duke marrë parasysh se AQP i zhvillon procedurat.	I zbatuar.
2	Menaxhimi i personelit	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurohet që para se të aprovoj pushimet pa pagesë t'i ketë shqyrtuar dëshmitë relevante në mënyrë që vendimi të jetë në përputhje me rregulloren për dhënien e pushimit pa pagesë.	Nuk kemi identifikuar raste të tilla në këtë vit.	I zbatuar.
3	Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale	Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj se kontrollet në procesin e ekzekutimit të pagesave janë duke u monitoruar në vazhdimësi.	Në bazë të testeve tona nuk kemi identifikuar raste të tilla.	I zbatuar.
4	Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj funksionalizimin e sistemit e-pasuria dhe trajnimin e zyrtarit të pasurive nga ana e MAP-it.	Ende nuk është venë në funksion sistemi e-pasuria.	I përsëritur
5	Progresi në zbatimin e rekomandimeve	Drejtori i Përgjithshëm duhet të rishikoj dhe analizoj shkaqet e rekomandimeve të pazbatuara, dhe të përcaktojë një afat të ri kohor për zbatimin e rekomandimeve, përfshirë edhe stafin llogaridhënës. Implementimi duhet të monitorohet në vazhdimësi.	Prej pesë rekomandimeve nga viti paraprak, katër prej tyre janë zbatuar dhe një mbetet i përsëritur.	I mbyllur.
Nr	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2018		
1	Pasuritë Kapitale dhe jokapitale	Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj funksionalizimin e sistemit e-pasuria dhe trajnimin e zyrtarit të pasurive nga ana e MAP-it.		

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të

cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Letërkonfirmimi



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Agjencia për Informim dhe Privatësi
Agjencia za Informisanje i Privatnost - Information and Privacy Agency

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2018 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturën dhe rekomandimin dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimit, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tij.

z. Bujar Sadiku



Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Data: 29.maj.2019, Prishtinë,